



Implemented by



15 Mars 2022

THIRRJE PËR APLIKIME

Programi për Aftësim Digjital

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të Kosovës (APK), me mbështetjen financiare Gjermane nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH shpallën thirrjen e hapur për aplikime në kuadër të Programit të Aftësive Digjitale (PAD).

RRETH PROGRAMIT

Programi është pjesë e projektit Programet aktive të Tregut të Punës 3 (PATP 3). Programi shfrytëzon potencialin e sektorit privat dhe përmirëson bazën e përgjithshme të aftësive të Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit (TIK) tek të rinjtë në Kosovë. Projekti mbështet grupet ekzistuese të rinjëve dhe të diplomuarve universitarë që kërkojnë të aftësohen dhe të rikualifikohen përmes qendrave vendore të çertifikimit në TIK.

Programi do të mbështesë 110 punëkërkuar të rinj në zhvillimin e aftësive digjitale ,përmes trajnimeve intensive në fushën e TIK-ut. Të rinjtë dhe të rejtat që aspirojnë të zgjerojnë njohuritë e tyre digjitale do të pajisen me aftësi në fushat e programimit, dizajnit dhe marketingu digjital, si dhe do të ju mundësohet inkuadrimi në praktikë në një nga kompanitë partnere të PAD sipas kriterëve.

Në fillim të vitit 2022, PAD kreu një Anketë për Vlerësimin e Nevojave të Aftësive me 100 kompani TIK, Media Digjitale dhe Dizajni. Si rezultat, gjashtë trajnime përgatitore janë përshtatur për të adresuar mospërputhjen e aftësive në tregun e punës të TIK-ut në Kosovë: aplikacione celulare, zhvillim uebeve, inxhinieri e të dhënave, rrjeta, marketingu digjital, dizajni digjital.

Aplikacione celulare	Zhvillim të WEB	Inxhinieri e të dhënave	Rrjeta	Marketing digjital	Dizajn digjital
SWIFT NodeJS React	JavaScript HTML CSS	SQL Python NoSQL (MongoDB,Redis)	CCNA	SEO Social Media Marketing Photoshop	ADOBE XD Photoshop 3D Animation Video Editing Apps

DAP-ja ZBATOHET NËPËRMJET HAPAVE TË MËPOSHTËM

Hapi i parë:

Pjesëmarrësit e interesuar duhet të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe të plotësojnë formularin e aplikimit që gjendet [këtu](#). Përpara se të vazhdojnë, aplikantët duhet të sigurojnë një kopje të skanuar të dokumenteve të mëposhtme:

- Transkripti - që tregon notën mesatare,
- ID (Numri personal) ,
- Certifikata e vendbanimit,
- Njoftim për aftësinë e kufizuar (HANDIKOS) - opsionale,

Hapi i dytë:

DAP do të vlerësojë të gjitha aplikimet bazuar në treguesit e mëposhtëm: nota mesatare (20%), diplomimi (10%), viti i diplomimit (10%), relevanca e shkollimit (10%), gjinia (10%), përkatësia etnike (10%), aftësia e kufizuar (10%), vendbanimi (10%), grupmosha (10%).

Shuma e pikëve për çdo kandidat do të përcaktojë renditjen dhe vendosjen në trajnime.

Hapi i tretë:

Bazuar në përzgjedhjen brenda Formularit të Aplikimit, çdo kandidat kualifikues do të njoftohet për vendosjen brenda trajnimeve. Programi do të mbështesë 110 punëkërkes të rinj në zhvillimin e aftësive digjitale përmes trajnimeve në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Të rinjtë dhe të rejtat që aspirojnë të zgjerojnë njohuritë e tyre digjitale do të pajisen me aftësi programuese . Trajnimet e propozuara zbatohen bazuar në modelin

Ready-to-Work (RTW) dhe do të ofrojnë aftësi praktike në programim, rrjeta, dizajn dhe marketing digjital.

Hapi i katërt:

Faza përfundimtare e DAP është Skema e Praktikës. 50 të përzgjedhur, nga 110 përfituesit e trajnimeve do të vendosen në kompanitë private, partnere të DAP. Procesi është konkurrues dhe ndjek parimin e përputhjes së aftësive ndërmjet përfituesve të DAP-së dhe kompanive private. **Vetëm punëkërkuessit e papunë, kandidatë që kanë përfunduar tashmë studimet kanë të drejtë për hapin e katërt, skemën e praktikës.**

KUSH MUND TË APLIKOJË?

APLIKANTËT

Personat e kualifikuar që mund të aplikojnë për DAP duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të jenë të rinj nën moshën 30 vjeç
- Studentët dhe të sapodiplomuarit
- Profilet e mëposhtme të akredituara inkurajohen për të aplikuar, ju lutemi kontrolloni listën e programeve **këtu**: Dizajni i produkteve, Artet Vizuale, Elektronika e Marketingut, Automatizimi dhe Robotika, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerësh, Shkenca Kompjuterike, Teknologji, Informatikë Biznesi, Dizajn Softuerësh, Shkenca Kompjuterike dhe Teknologjitë e Komunikimit, E-Qeverisja, Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale, Inxhinieria dhe Informatika, Dizajn Grafik dhe Multimedia, Inxhinieri Industriale me Informatikë, Informatikë e Aplikuar, Menaxhim dhe Informatikë, Dizajn Grafik, Marketing dhe Biznes, Komunikim masiv, Programim, Kompjuter dhe Teknologjitë e Informacionit, Artet dhe Shkencat e Aplikuara, Dizajni i Komunikimit, Teknologjia e Aplikuar e Informacionit, Shkenca Kompjuterike - Dizajni i Softuerit, Shkenca e të Dhënave dhe Analitika e Biznesit, Artet dhe Media Dixhitale, Dizajni i Integruar, Media dhe Komunikimi, Menaxhimi i Mekatronikës, Muzika moderne dhe Prodhimi dhe Menaxhimi dixhital , Kompjuter Shkencë dhe Inxhinieri, Sistemet e Informacionit.
- **Programe të tjera studimi janë gjithashtu të pranueshme, megjithatë vendosja në trajnime e studentëve nga programet tjera është e kushtëzuar me rezultatet e intervistës.**

Grupet me prioritet:

- Të sapodiplomuarit (nga 2017 – 2021)
- Të rinjtë (18 -24)

- Gratë
- Persona nga zonat rurale
- Personat me aftësi të kufizuara
- Grupet e pakicave etnike

Personat që nuk kanë të drejtë për aplikim janë :

- Nuk i përkasin grupmoshës 18-30 vjeç
- Të kenë përfituar më parë nga Programi i Praktikës ose nga masa të tjera aktive punësimi.
- Janë në konflikt interesi me palët e interesuara të Programit dhe vendimmarrësit.

Thirrja për aplikim është e hapur deri më 08 prill 2022 në orën 17:00

MBESHTETJE FINANCIARE

Kostoja e trajnimeve mbulohet nga Programi.Praktika, për përfituesit e përzgjedhur duke përfshirë sigurimin e kompensimit të dëmeve në vendin e punës dhe mbulimi kostove esenciale të udhëtimit mbulohet gjithashtu nga Programi. Kandidatët që kryejnë praktikën gjashtëmujore do të pajisen me certifikatë për përfundimin e praktikës.

Informacion shtese

Çdo aplikim që nuk plotësohet dhe bie jashtë kriterëve të kësaj thirrjeje për aplikim, nuk do të merret parasysh.

Rreth Projektit PATP3 të UNDP-së në Kosovë

PATP 3 synon të krijojë lidhje të qëndrueshme për rritje bizneseve dhe të krijojë mundësi për zhvillimin e aftësive për punëkërkesit e rinj në tregun e punës në Kosovë. Duke pasur një qasje të dyfishtë, projekti synon fuqizimin e bizneseve të krijuara përmes Programit të Vetëpunësimit (PVP) duke ofruar mundësi shtesë për punësim për punëkërkesit e riadhesuar përmes Programit për Zgjerimin dhe Mbështetjen e Bizneseve (PZMB). Më tej, projekti synon fuqizimin e të rinjëve, për t'u pajisur me aftësitë e nevojshme për karriere në një epokë digjitale. nekuadër të Programit të Aftësive Digjitale (PAD). Si pjesë e kësaj mbështetjeje, të rinjtë dhe të rejtat do të pajisen me aftësi programimi në fushat e TIK.

KUJDES VEÇANTË gjatë procesit të aplikimit:

- Mbjajtja e maskave, mbajtja e distancës dhe larja e duarve sipas udhëzimeve të IKSHP dhe OBSH.

- Në çdo zyrë do të mbahet një distancë prej 2 metrash në të gjitha hapësirat.